

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë**, me gjyqtarin Gëzim Pozhegu – kryetari i trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arbënore Basha, lidhur me çështjen penale kundër të akuzuarit Q. M. nga fsh. D., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, duke vendosur për aprovimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë sipas propozimit të Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë PP/I.nr. 155/2016 të datës 11.01.2017, në seancën e shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë Ali Uka, të akuzuarit Q. M., mbrojtësit avokat F. Zh. nga Gjakova si dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës KK Rahovec B. B., **me datë 16.03.2017**, publikisht shpalli këtë :

## A K T G J Y K I M

I akuzuari:

**Q. M.** nga i ati K. dhe e ëma Z., e vajzërisë Th., i lindur me datë ... në fshatin D., K. e Rahovecit, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, Zyrtar i gjendjes civile në Komunën e Rahovecit, i martuar, baba i 5 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, kinse i padënuar më parë.

## Ë S H T Ë F A J T O R

**Për shkak se :**

Në periudhën kohore janar-qershor të vitit 2016, në zyrën e gjendjes civile në fshatin Ratkoc, K. e Rahovecit, me qëllim të përvetësimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete, ka keqpërdor pozitën apo autorizimet zyrtare dhe duke i shkaktuar dëm Komunës së Rahovecit në atë mënyrë që i pandehuri si zyrtar i gjendjes civile, ka leshur certifikatat e gjendjes civile dhe atë 512 ekstrakte dhe certifikata të lindjes, 8 certifikata të vdekjes, 16 certifikata të deklarata të statusit martesor, 4 certifikata të shtetësisë, 58 certifikata të vendbanimit, 86 certifikata të bashkësisë familjare, 32 certifikata të martesës, kështu që taksat e këtyre dokumenteve të gjendjes civile nuk janë derdhur në arkën e komunës, por të njëjtat para i ka mbajtur për vete, dhe atë shumën e përgjithshme prej 1.166,00 euro që i ka shkaktuar dëm buxhetit të Komunës.

**-me çka ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata me aplikimin e neneve 6, 7, 17, 41, 43, 45, 46, 47, 73, 75 par.1 pika 1.3 dhe nenit 76, 83, nenit 422 par.1 të KPRK-së si dhe neneve 359 par.2, 365, 366, 450 të KPPK-së, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

### **DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ GJASHTË (6) MUAJVE**

Në bazë të kërkesës së të dënuarit për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë në kuptim të nenit 47 të KPRK-së, dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh zëvendësohet me dënim me gjobë, andaj

**Gjykata të dënuarit i shqipton :**

### **DENIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ (njëmijepesëqind euro) 1.500,00 €**

Dënim me gjobë në shumën prej 1.500,00 € (njëmijepesëqind euro), shumë të cilën obligohet ta paguaj pasi që ky Aktgjykim të merr formë të prerë, në tri kiste, dënimi me gjobë të paguhet në tërësi, më së largu deri më 31.06.2017.

Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet brenda fatit të paraparë atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burg, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga 20 € (njëzet euro).

Në kuptim të nenit 464 të KPK-së obligohet i dënuari që shumën prej 1.166,00 euro t' ia kthejë të dëmtuarës Komunës së Rahovecit.

Në kuptim të nenit 450 parag.4 të KPPK-së, të dënuarit obligohen në pagesën e shpenzimeve të paushallit gjyqësor në shumën prej 25 €, si dhe në emër të shpenzimeve gjyqësore shumën prej 25 €, të cilat shuma duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 155/2016 të datës 11.01.2017, kundër të akuzuarit Q. M. nga fsh. D., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale : keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Po ashtu Prokuroria Themelore DKR në Gjakovë ka parashtruar propozimin PP/I.nr. 155/2016 të datës 11.01.2017, me të cilën i ka propozuar kësaj Gjykate që këtë çështje ta zgjidhë me marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjykata shqyrtimin gjyqësor për vendosjen mbi propozimin për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë e ka mbajtur me datën 14.03.2017, ku kanë qenë prezentë Prokurori i shtetit Ali Uka, i akuzuari dhe mbrojtësja e tij av. F. Zh. nga Gjakova.

Gjykata gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij si dhe përfaqësuesin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë DKR, prokurorin e shtetit Ali Uka.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se në tërësi ngelet pranë marrëveshjes me PP/I.nr.48/2014 të dt. 04.01.2017, e lidhur në mes prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, për të cilën lidhur me kushtet e llojet e dënimit është njoftuar gjykata, si dhe vet i akuzuari, andaj përveç kushteve të caktuara në këtë marrëveshje ne si prokurori nuk kemi çka të shtojmë dhe i propozojmë gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet dhe të jetë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës. Duke u mbështetur në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, si dhe kushteve të përcaktuara në te, i propozojë KTGJ që ndaj të akuzuarit Q. M. të shqiptojë një dënim në suaza të dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) - 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim do të zëvendësohet me të holla në lartës i prej 1.000,00 € - 1.500,00 € dhe të obligohet i akuzuari që ti kthejë shumën e parave në vlerë prej 1.116,00 € në buxhet të Komunës së Rahovecit.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës KK Rahovec, B. B., deklaron se i bashka ngjitimi ndjekjes penale njëherit kërkojmë kompensimin e dëmit material, njëherit kërkojmë që të deklarohet lidhur me të tjera.

Mbrojtësja e të akuzuarit Q. M., av. F. Zh. nga Gjakova, ka deklaruar se: mbetem në tërësi pranë marrëveshjes së arritur në PTH në Gjakovë me datë 11.01.2017, meqenëse i mbrojturi im Q. M. në mënyrë vullnetare, pa ndikim të askujt ka pranuar veprën penale e cila i vehet në barrë. Andaj i propozojë kësaj gjykate, që të mbrojturit tim t'ia shqiptojë minimumin e dënimit me burg prej 5- 6 muajve, i cili do të zëvendësohet me të holla në lartësi prej 1.000,00 € - 1.500,00 €, duke marrë parasysh se i njëjti është mbajtës i familjes dhe obligohet që ti kthejë paratë në shumë prej 1.166,00 €.

I akuzuari Q. M., ka deklaruar se : e mbështetë propozimin e mbrojtëses të tij, si dhe marrëveshjen e arritur me prokurorin.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka konstatuar se i akuzuari Q. M., ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim është bërë në baza vullnetare, pas konsultimeve të nevojshme me mbrojtësen e tij, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova të cilat janë paraqitur në aktakuzë dhe janë pranuar edhe nga vet i akuzuari. Po ashtu gjykata ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë për hudhjen e aktakuzës, apo atë pushimit të procedurës penale të parapara nga neni 248 par.3 të KPPK-së.

Gjykata gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi e ka vërtetuar jo vetëm nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit por edhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e për të cilat prova mbrojtja nuk ka pasur kundërshtime, siç janë : raporti fillestar rreth incidentit, raporti mbi masat e fshehta të zbulimit të dhënave financiare të lëshuara nga urdhri i gjykatës, raporti final i auditimit i bërë për Komunën e Rahovecit, tarifat e dhëna me shkrim, vërejtja e dhënë nga drejtori i administratës për punëtorin e gjendjes civile Q. M., deklarata e të pandehurit e dhënë në procedurën

paraprake, deklarata e dhënë nga dëshmitarët rreth rastit, tarifat e caktuara nga ministria dhe komuna për taksat e dokumenteve të gjendjes civile si dhe shkresat tjera të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Andaj, Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të pranojë fajësinë e të akuzuarit dhe të akuzuarin e shpallë fajtor dhe ta dënojë në bazë të ligjit.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit Prokurori i çështjes ka deklaruar se mbetet pranë dënimit të rekomanduar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të paraparë në faqen 1 dhe 2 të marrëveshjes, ku është propozuar që dënimi për veprën penale : keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së , të jetë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) deri në 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim ti zëvendësohet me të holla në lartësi prej 1.000 – 1500 euro dhe obligohet i akuzuari që ti kthejë paratë shumë prej 1.166 euro, komunës së Rahovecit në buxhet të kësaj komune të cekura në marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjykata duke vendosur mbi sanksionin penal juridik të propozuar në marrëveshje ka vlerësuar të gjitha rrethanat konform nenit 73, 75 par.1 pika 1.3 dhe nenit 76 të KPRK-së që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti pranimin e fajësisë nga ana e tij në të gjitha fazat e procedurës penale, pendimin e tij për veprën e kryer, qëndrimin e tij korrekt gjatë gjykimit, jo denueshmërinë e tij, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin në kuadër të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë duke shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim iu është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1.500,00 € (njëmijepesëqind euro), me shpresë dhe bindje se dënimi i shqiptuar do të arrijë qëllimin e dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi kthimin e të hollave të dëmtuarës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në pajtim me nenin 464 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par.1 të KPRK-së është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE – Departamenti për Krime të rënda në Gjakovë,  
PKr.nr. 2/17, datë 16.03.2017**

**Sekretarja juridike,**  
Arbënore Basha

**Kryetari trupit gjykues-Gjyqtari,**  
Gëzim Pozhegu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të aktgjykimit.